



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 9, Datë 16.02.2015

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË SUBJEKTEVE ZHVILLUESE NË “LEJEN
ZHVILLIMORE KOMPLEKSE PËR NDËRTIMIN E RESORTIT TURISTIK “NEW
BORN”, MIRATUAR ME VENDIM NR. 10, DATË 10.05.2013 TË KKT”, ME
VENDONDODHJE BASHKIA SUKTH, QARKU DURRËS

Në mbështetje të neneve 27, 28, 40 dhe 59 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, VKM nr. 877, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratohet kërkesa e subjekteve zhvilluese “Mane TCI” sh.p.k, “Startek” sh.p.k, “Alentre” sh.p.k, për zëvendësimin e subjekteve zhvilluese në “Lejen Zhvillimore Komplekse për ndërtimin e Resortit turistik “New Born”, miratuar me Vendim nr. 10, datë 10.05.2013 të KKT-së”, si më poshtë:
 - Subjekti zhvillues “Concord” sh.p.k zëvendësohet me subjektin zhvillues “Startek” sh.p.k;
 - Subjekti zhvillues “Jo - ID” sh.p.k zëvendësohet me subjektin zhvillues “Alentre” sh.p.k.
2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



Z. ARBEN AHMETAJ

MINISTËR I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

Adelina Greca



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT